



TREGU I PUNËS

LABOUR MARKET

TREGU I PUNËS 2019

Labour Market 2019

Drejtor botimi/Director of the Publication: **Elsa Dhuli**

Punoi/Prepared: Ledia Thomo
Elda Muça
Julinda Haçkaj
Ornela Fitezi

© Copyright INSTAT 2020

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by any means without the prior written permission of the copyright holder.

Përpunimi në kompjuter / Computer processing:

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTJA**CONTENT****KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË TREGUT TË PUNËS
NË SHQIPËRI, 2019**

GENERAL CHARACTERISTICS OF THE LABOUR MARKET IN ALBANIA, 2019

11**PUNËSIMI**

EMPLOYMENT

15**PAPUNËSIA**

UNEMPLOYMENT

18**POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE (JASHTË
FORCAVE TË PUNËS)**ECONOMICALLY INACTIVE POPULATION (OUTSIDE THE LABOUR
MARKET)**22****TË RINJTË JO NË PUNËSIM E AS DUKE NDJEKUR
SHKOLLËN APO NDONJË TRAJNIM**

YOUTH NEITHER IN EMPLOYMENT NOR IN EDUCATION OR TRAINING

16**TREGUES SIPAS QARQEVE**

INDICATORS BY PREFECTURES

24**PAGAT**

WAGES

26**Tab.1.1****Forca e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Labour force by education, age and sex

28**Tab.1.2****Punësimi sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Employment by education, age and sex

29

Tab.1.3

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Labour force participation rate by education, age and sex

30**Tab.1.4**

Shkalla e punësimit sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Employment rate by education, age and sex

31**Tab.1.5**

Përqindja e të punësuarve me pagë në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Share of employees in total employment by education, age and sex

32**Tab.1.6**

Përqindja e të vetë-punësuarve në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Share of self-employment in total employment by education, age and sex

33**Tab.1.7**

Përqindja e të punësuarve si punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Share of contributing family workers in total employment by education, age and sex

34**Tab.1.8**

Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik (sipas NVE Rev.2)

Employment structure by sex and economic activity (according to NACE Rev.2)

35**Tab. 1.9**

Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe profesionit (sipas ISCO-08)

Employment structure by sex and occupation (according to ISCO-08)

36

Tab.1.10

Punësimi sipas gjinisë dhe orëve aktuale të punës në javë

Employment by sex and weekly hours actually worked

37

Tab.1.11

Orët mesatare aktuale javore të punës sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik

Mean weekly hours actually worked per employed person by sex and economic activity

38

Tab.1.12

Orët mesatare aktuale javore të punës për të punësuarit me pagë sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik

Mean weekly hours actually worked per employee by sex and economic activity

39

Tab.1.13

Përqindja e të punësuarve me pagë me kontratë të përkohshme ndaj të punësuarve me pagë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Share of temporary employees to total employees by education, age and sex

40

Tab.1.14

Përqindja e të punësuarve me kohë të pjesëshme* ndaj të punësuarve gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Share of part time employment* to total employment by education, age and sex

41

Tab.1.15

Popullsia në moshë pune sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Working age population by education, age and sex

42

Tab.1.16

Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Economically inactive population by education, age and sex

43

Tab.2.1**Papunësia sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Unemployment by education, age and sex

44

Tab.2.2**Shkalla e papunësisë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Unemployment rate by education, age and sex

45

Tab.2.3**Papunësia afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Long term unemployment by education, age and sex

46

Tab.2.4**Shkalla e papunësisë afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Long term unemployment rate by education, age and sex

47

Tab.2.5**Përqindja e të papunëve afatgjatë në papunësinë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë**

Share of long term unemployed to unemployment by education, age and sex

48

Tab.3.1**Forca e punës sipas qarqeve dhe gjinisë**

Labour Force by prefectures and sex

49

Tab.3.2**Punësimi sipas qarqeve dhe gjinisë**

Employment by prefectures and sex

59

Tab.3.3**Punësimi sipas qarqeve dhe sektorëve kryesorë të ekonomisë**

Employment by prefectures and main economic activities

50

Tab.3.4**Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas qarqeve dhe gjinisë**

Labour Force participation rate by prefectures and sex

50

Tab.3.5**Shkalla e punësimit sipas qarqeve dhe gjinisë**

Employment rate by prefectures and sex

51

Tab.3.6**Popullsia në moshë pune sipas qarqeve dhe gjinisë**

Working age population by prefectures and sex

51

Tab.3.7**Papunësia sipas qarqeve dhe gjinisë**

Unemployment by prefectures and sex

52

Tab.3.8**Shkalla e papunësisë sipas qarqeve dhe gjinisë**

Unemployment rate by prefectures and sex

52

Tab.3.9**Popullsia ekonomisht jo aktive sipas qarqeve dhe gjinisë**

Economically inactive population by prefectures and sex

53

Tab.4.1**Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë**

Gross average monthly wage per employee by economic activities and sex

54

Tab.4.2**Hendeku gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike**

Gender pay gap by economic activity

55

Tab.4.3**Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas group-profesioneve dhe gjinisë**

Gross average monthly wage per employee by group of occupations and sex

56

Tab.4.4**Hendeku gjinor në paga sipas grup-profesioneve**

Gender pay gap by occupation groups

56

Tab.4.5**Shpërndarja e kontribuuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto dhe gjinisë**

Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals and sex

57

SHËNIME METODOLOGJIKE**METHODOLOGICAL NOTES**

58


Tab. A**DEVIJIMET STANDARDE TË PËRGJITHSHME TË ZGJEDHJES PËR TREGUESIT KRYESORË TË TREGUT TË PUNËS**

Generalised sampling standard deviations for the main labour market indicators

59

PËRKUFIZIME KRYESORE**MAIN DEFINITIONS**

60



KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË TREGUT TË PUNËS NË SHQIPËRI, 2019

Statistikat e tregut të punës në Shqipëri bazohen në dy burime kryesore, anketat dhe të dhënat administrative. Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vërtetim statistikor i vazhdueshëm i cili mbledh informacion cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të gjithë individët 15 vjeç e lart në Shqipëri. AFP mundëson jo vetëm marrjen e vlerësimeve për një gamë të gjerë treguesish të ofertës për punë të disagreguar sipas gjinisë dhe arsimit, por dhe përdoret gjerësisht për hartimin e politikave dhe strategjive të punësimit në nivel kombëtar dhe për grupe specifike të popullsisë. Në këtë publikim, përveç të dhënave të vlerësuara sipas AFP, janë përdorur dhe të dhëna nga burimet administrative. Treguesit e llogaritur me të dhënat administrative janë paga mesatare mujore bruto disagreguar sipas gjinisë, grup-aktiviteteve ekonomike dhe grup-profesioneve.

Gjatë vitit 2019 sipas vlerësimeve të marra nga Anketa e Forcave të Punës:

- Forca e punës është 1.430 mijë persona. Meshkujt përbëjnë 55,6 % të forcës së punës dhe femrat 44,4 %.
- Të punësuar janë 1.266 mijë persona, ku meshkujt përbëjnë 55,5 % të të punësuarve dhe femrat 44,5 %.
- Të papunë janë 165 mijë persona, ndër të cilët 56,0 % janë meshkuj dhe 44,0 % janë femra.
- Shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshën 15-74 vjeç është 11,5 %. Për meshkujt shkalla e papunësisë është 0,2 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat.
- Nga viti 2018 në vitin 2019 punësimi është rritur me 2,8 %, ndërsa shkalla zyrtare e papunësisë (për grup-moshën 15-74 vjeç) është ulur me 0,8 pikë përqindje.
- 61,2 % e popullsisë 15-64 vjeç¹ është e punësuar, 8,4 % është e papunë dhe 30,4 % është ekonomikisht jo aktive (jashtë forcave të punës).

1. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç, ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, që përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të gatshëm për punë, prandaj ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

GENERAL CHARACTERISTICS OF THE LABOUR MARKET IN ALBANIA, 2019

Labor market statistics in Albania are based on two main sources, surveys and administrative data. The Labor Force Survey (LFS) is a continuous statistical survey that collects qualitative and quantitative information to assess key labor market indicators for all individuals aged 15 years and over in Albania. LFS enables not only the availability of estimations for a wide range of gender and education disaggregated indicators of job supply, but is also widely used to develop policies and employment strategies at national level and for specific population groups. In this publication, besides the data evaluated according to LFS, also data from administrative sources are used. Calculated indicators with administrative data are the average monthly gross wage disaggregated by gender, economic activities groups and occupations groups.

Over the year 2019, according to Labour Force Survey estimates:

- Labour force is 1,430 thousand persons. Males account for 55.6 % of the labour force and females for 44.4 %.
- Employment is 1,266 thousand persons, from which males account for 55.5 % and females for 44.5 %.
- There were 165 thousand unemployed; 56.0 % of those are males and 44.0 % are females.
- The official unemployment rate for the age-group 15-74 years old is 11.5 %. The unemployment rate is 0.2 percentage points higher for males than females.
- From 2018 to 2019 employment has increased by 2.8 % and the official unemployment rate (15-74 years old) has decreased by 0.8 percentage points.
- 61.2 % of the population aged 15-64 years old¹ is employed, 8.4 % is unemployed and 30.4 % is economically inactive (outside the labour force).

1. The labour force participation and employment rates are calculated based on the population aged 15 to 64 years whereas; the unemployment rate is calculated based on the economically active population (labour force) aged 15 and over. The employment and labour force participation rates calculated for those aged 15 and over are affected by the inclusion of the retired population in the denominator and are therefore less meaningful than the rates calculated for those aged from 15 to 64. However, for calculating the unemployment rate for those aged 15 and over, the denominator is the economically active population which includes people in work or actively seeking and ready to work. Therefore, this indicator is not affected by the population over the retirement age.

- 68,2 % e meshkujve 15-64 vjeç janë të punësuar, 9,4 % janë të papunë dhe 22,4 % janë jashtë forcave të punës.
- 54,4 % e femrave 15-64 vjeç janë të punësuar, 7,3 % janë të papuna dhe 38,4 % janë jashtë forcave të punës.
- Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 52.380 lekë.
- Krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,5 %.
- Hendeku gjinor në paga është 10,1 %. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,1 % më të lartë sesa femrat.
- Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2019 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 0,6 pikë përqindje.
- Gjatë vitit 2019, 27,9 % e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.
- 68.2 % of male population aged 15-64 years old are employed, 9.4 % are unemployed and 22.4 % are outside the labour force.
- 54.4 % of female population aged 15-64 years old are employed, 7.3 % are unemployed and 38.4 % are outside the labour force.
- The average monthly gross wage for an employee in Albania is 52,380 ALL.
- Compared to 2018, the average monthly gross wage for an employee in Albania increased by 3.5 %.
- The gender pay gap is 10.1 %. So men have a gross monthly average wage of 10.1 % higher than women.
- Compared to the previous year, in 2019 there is a decrease of the gender pay gap by 0.6 percentage points.
- During 2019, 27.9 % of contributors of the category of employees receive an average monthly gross wage up to the official minimum wage level.




Fig. 1 Shpërndarja e popullsisë 15-64 vjeç sipas statusit të aktivitetit ekonomik dhe gjinisë, 2019

Distribution of population aged 15-64 years old by economic activity status and sex, 2019





Fig. 2 Shpërndarja e popullsisë 15-64 vjeç sipas statusit të aktivitetit ekonomik, 2018-2019

Distribution of population aged 15-64 years old by economic activity status, 2018-2019



PUNËSIMI

Gjatë vitit 2019 numri i të punësuarve në Shqipëri është 1.266 mijë persona. Krahasuar me vitin pararendës punësimi u rrit me 2,8 %.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 69,6 %. Për meshkujt e moshës 15-64 vjeç shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 16,0 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat.

Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 61,2 %. Shkalla e punësimit për femrat është 54,4 % dhe për meshkujt 68,2 %. Hendeku gjinor në punësim për këtë grup-moshë është 13,8 pikë përqindje.

Spektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,5 % dhe 36,4 % të të punësuarve gjithsej.

Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve reflekton strukturën e punësimit sipas sektorëve. Në vitin 2019, punonjësit e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit përbëjnë 47,3 % të të punësuarve. Nëpunësit dhe punonjësit e shitjeve dhe shërbimeve përbëjnë 19,1 % të të punësuarve.

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2019, rezultojnë se 45,7 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,3 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 22,0 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

EMPLOYMENT

Over the year 2019 the number of employed in Albania is 1,266 thousand persons. Compared to the previous year employment has increased by 2.8 %.

Labour force participation rate for the population aged 15-64 years old is 69.6 %. For male population aged 15-64, the labour force participation rate is 16.0 percentage points higher than females.

The employment rate for the population aged 15-64 years old is 61.2 %. The employment rate for females is 54.4 % and for males 68.2 %. The gender gap in employment for this age-group is 13.8 percentage points.

The service and agricultural sectors have the highest share of employed with respectively 43.5 % and 36.4 % of the total employment.

Analysis of employment by main occupation groups reflects the employment structure by sectors. In 2019, agricultural workers account for 47.3 % of total employment. Clerical, service and sales workers account for 19.1 % of employed.

According to the 2019 survey estimates, 45.7 % of employed are employees, 32.3 % are self-employed (with employees or without employees) and 22.0 % are contributing family workers.





Fig. 3 Punësimi (15+) sipas aktiviteteve ekonomike, 2019

Employment (15+) by economic activities, 2019



- Të punësuar me pagë
Employees
- Të vetë-punësuar
Self-employed
- Punëtorë pa pagesë në
biznesin e familjes
Contributing family workers

Fig. 4 Punësimi (15+) sipas statusit në punësim, 2018-2019

Employment (15+) by status in employment, 2018-2019

Duke e analizuar tregun e punës në këndvështrimin gjinor, vihet se femrat kanë 1,8 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

Vlerësimet e marra nga AFP tregojnë se 29,0 % e femrave të punësuar dhe 16,4 % e meshkujve të punësuar janë punëtorë pa pagesë të familjes.

Në vitin 2019 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 30,0 %, duke pësuar një rritje me 0,6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018.

In a gender perspective, females are 1.8 times more likely than males to be contributing family workers.

LFS estimates show that 29.0 % of employed females and 16.4 % of employed males are contributing family workers.

In 2019, the share of informal employment in the non-agricultural sector is 30.0 %, increasing by 0.6 percentage points, compared to 2018



PAPUNËSIA

Gjatë vitit 2019 numri i të papunëve në Shqipëri është 164.792 persona. Shkalla zyrtare e papunësisë është 11,5 % dhe u ul me 0,8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018. Shkalla zyrtare e papunësisë për meshkujt është 11,6 % dhe për femrat është 11,4 %.

Shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 27,2 %. Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve pësoi një rënie prej 1,1 pikë përqindje.




Fig. 5 Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave, 2018-2019

Unemployment rate by age groups, 2018-2019

Personat e papunë prej një viti a më shumë përbëjnë 63,4 % të të papunëve gjithsej. Krahasuar me vitin e mëparshëm, pesha që zënë të papunët afatgjatë në papunësinë gjithsej është ulur me 4,0 pikë përqindje.

Duke analizuar shkallën e papunësisë sipas nivelit arsimor në vitin 2019, vihet re që shkalla e papunësisë është më e lartë për personat me arsim të mesëm (14,4 %) ndjekur nga ata me arsim të lartë (12,3 %).

Gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin e mëparshëm, pati një rënie të shkallës së papunësisë për personat me arsim 8/9 vjeçar me 1,2 pikë përqindje dhe për personat me arsim të lartë me 1,7 pikë përqindje. Ndërsa për personat me arsim të mesëm, pati një rritje të shkallës së papunësisë me 0,1 pikë përqindje.

UNEMPLOYMENT

Over the year 2019, the number of unemployed in Albania is 164,792 persons. The official unemployment rate is 11.5 %, decreasing by 0.8 percentage points compared to 2018. The official unemployment rate for males is 11.6 % and for females is 11.4 %.

Youth (15-24 years old) unemployment rate is 27.2 %. Compared to the previous year, youth unemployment rate has decreased by 1.1 percentage points.

Unemployed persons since one year or more account for 63.4 % of all unemployed. Compared to the previous year, the share of long term unemployed to the total unemployment has decreased by 4.0 percentage points.

Analysis of the unemployment rate by educational level shows that in 2019 the unemployment rate is higher among persons with upper secondary education (14.4 %) followed by those with tertiary education (12.3 %).

Over the year 2019, the unemployment rate decreased among persons with 8/9 years school education by 1.2 percentage points and for persons with tertiary education by 1.7 percentage points compared to the previous year. Whereas for persons with upper secondary education, the unemployment rate increased by 0.1 percentage points.





Fig.6 Shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor (popullsia 15+), 2018-2019

Unemployment rate by educational level (population 15+), 2018-2019



POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE (JASHTË FORCAVE TË PUNËS)

Gjatë vitit 2019, 30,4 % e popullsisë 15-64 vjeç është ekonomikisht jo-aktive. Struktura e popullsisë jashtë forcave të punës është e dominuar nga nxënësit/studentët (38,5 %).

Në këtë grup-moshë, pjesa që zënë personat e papunë të cilët nuk po kërkojnë punë për arsye se besojnë se nuk ka punë të disponueshme është 9,2 %.

Ndër popullsinë e meshkujve të moshës 15-64 vjeç ekonomikisht jo aktivë 15,2 % janë të papunë të dekurajuar, 48,2 % janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm, 6,0 % në pension ose pension të parakohshëm, 6,0 % në pension ose pension të parakohshëm.

ECONOMICALLY INACTIVE POPULATION (OUTSIDE THE LABOUR MARKET)

Over the year 2019, 30.4 % of the population aged 15-64 years old is economically inactive. The structure of the population outside labour market is dominated by pupils/students (38.5 %).

In this age-group, 9.2 % are not looking for a job because they believe there are not available jobs.

Among the economically inactive male population aged 15-64 years old, 15.2 % are discouraged workers, 48.2 % are pupils/students or in further training, 6.0 % are in retirement or early retirement, 6.0 % are in retirement or early retirement.




Fig. 7 Struktura e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht jo aktive sipas gjinisë, 2019


Structure of the economically inactive population aged 15-64 years old by sex, 2019

Ndër popullsinë e femrave të moshës 15-64 vjeç ekonomikisht jo aktive 5,8 % janë të papunë të dekurajuar, 33,0 % janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm, 15,3 % në pension ose pension të parakohshëm dhe 26,6 % e tyre janë duke përmbyshur detyrat shtëpiake.

Among the economically inactive female population aged 15-64 years old, 5.8 % are discouraged workers, 33.0 % are pupils/students or in further training, 15.3 % are in retirement or early retirement, and 26.6 % of them are fulfilling domestic tasks.

TË RINJTË JO NË PUNËSIM E AS DUKE NDJEKUR SHKOLLËN APO NDOJË TRAJNIM

Në vitin 2019, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç as në punësim e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 26,6 % të të rinjve gjithsej. Në këtë grup, 36,5 % e të rinjve janë të papunë. Pjesa tjetër janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (12,7 %), duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (18,1 %) ose për arsye të tjera (32,7 %).



Duke krahasuar të rinjtë që janë as të punësuar as në shkollë apo trajnim profesional sipas gjinisë dhe statusit të tyre në tregun e punës, vihet re se meshkujt janë më aktivë në treg sesa femrat (45,3 % e meshkujve janë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për të punuar, ndërsa tek femrat kjo përqindje është 28,9 %).

YOUTH NEITHER IN EMPLOYMENT NOR IN EDUCATION OR TRAINING

Over the year 2019, youth aged 15-29 years old neither in employment nor in education or training account for 26.6 % of all youth population. In this group, 36.5 % are unemployed. The other part is outside the labour force because they are discouraged workers (12.7 %) or fulfilling domestic and family responsibilities (18.1 %) or for other reasons (32.7 %).

Fig. 8 Të rinjtë (15-29 vjeç) jo në punësim dhe as duke ndjekur shkollën, sipas statusit në tregun e punës, 2019

Youth (15-29) neither in employment nor in education, by labour market status, 2019

Comparing youth who are neither in employment nor in education or training by sex and their status in the labour market, it is noted that males are more active than females (45.3 % of males are seeking for a job and are available to work, while for females this percentage is 28.9 %).

TREGUES SIPAS QARQEVE

Në vitin 2019, qarqet me shkallë punësimi më të lartë janë: Berat (65,7 %) dhe Korçë (63,2 %), ndërsa qarku me shkallë punësimi më të ulët është qarku Lezhë (41,7 %).

Qarqet me shkallë papunësie më të lartë janë qarku i Lezhës me 17,7 % dhe qarku i Vlorës me 15,2 %.

Në vitin 2019, në qarkun e Tiranës, shërbimet punësojnë pjesën më të madhe të të punësuarve gjithsej, 66,3 % të tyre. Në këtë qark 26,3 % e të punësuarve gjithsej janë të punësuar në sektorin e industrisë dhe vetëm 7,3 % e tyre punojnë në bujqësi. Qarku i Durrësit ka rreth 51,4 % e të punësuarve të angazhuar në sektorin e shërbimeve, 35,2 % në sektorin e industrisë dhe 13,4 % në sektorin e bujqësisë. Në qarkun e Vlorës dhe Lezhës respektivisht 39,7 % dhe 48,6 % e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve, 26,6 % dhe 22,4 % në sektorin e industrisë dhe 33,7 % dhe 29,0 % në sektorin e bujqësisë. Në qarqet e tjera të vendit është punësimi në bujqësi ai që zë një peshë të konsiderueshme me 45 % e më shumë.

INDICATORS BY PREFECTURES

In 2019, prefectures with the highest employment rate are: Berat (65.7 %) and Korçë (63.2 %), whereas the prefecture with the lowest employment rate is Lezhë (41.7 %).

Prefectures with highest unemployment rate are prefectures of Lezhë with 17.7 % and Vlorë with 15.2 %.

In 2019, in the prefecture of Tirana, services employ the major part of the total employed, 66.3 %. In this prefecture 26.3 % of the total employed is in industry while only 7.3 % of them are engaged in agriculture activities. The prefecture of Durrës has 51.4 % of employed engaged in services, 35.2 % in industry and 13.4 % in agriculture. In prefectures of Vlorë and Lezhë respectively 39.7 % and 48.6 % of employed work in services sector, 26.6 % and 22.4 % in industry and 33.7 % and 29.0 % in agriculture. In other prefectures of the country, it is the employment in agriculture that prevails with 45 % or more of the total employment.





Fig. 9 Struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë, 2019

Employment structure by prefectures and economic sectors, 2019



PAGAT

Në vitin 2019, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 52.380 lekë. Kjo pagë është llogaritur me të dhënat e listë-pagesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, dhe mbulon të gjithë sektorët e ekonomisë dhe kontribuesit, shtetas shqiptarë e të huaj, për të cilët ndërmarrja deklaron pagë mujore bruto.

WAGES

In 2019, in Albania, the average monthly gross wage per employee is 52,380 ALL. This wage is calculated based on the enterprises' payrolls declared to the General Directorate of Taxation for contributions on social security, health and tax on income from employment. It covers all sectors of economy and contributors, albanian and foreign citizens for whom the enterprise declares a gross monthly wage.




Fig. 10 Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto, 2019

Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals, 2019

Krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,5 %. Hendeku gjinor në paga është 10,1 %. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,1 % më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2019 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 0,6 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2019, 27,9 % e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2019, paga minimale zyrtare është 26.000 lekë.

Paga mesatare mujore bruto është mbi nivelin mesatar për aktivitetet ekonomike si: Aktivitetet financiare dhe të sigurimit, Informacioni dhe komunikacioni, Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale. Ndërsa aktivitetet ekonomike me pagë poshtë nivelit mesatar janë: Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor; dhe Bujqësia, Silvikultura dhe Peshkimi.

Compared to 2018, the average monthly gross wage per employee is increased by 3.5 %. The gender pay gap is 10.1 %. So men have average monthly gross wage of 10.1 % higher than women. Compared to the previous year, in 2019 there is a decrease of the gender pay gap by 0.6 percentage points.

During 2019, 27.9 % of employees receive an average monthly gross wage up to official minimum wage. For the year 2019, the official minimum wage is 26,000 ALL.

The average monthly gross wage is above the average for economic activities such as: Financial and Insurance Activities, Information and communication, Public administration and defense; compulsory social security; education; human health and social work activities. While economic activities below the average level are: Wholesale and retail trade; repair of motor vehicles and motorcycles; transport and storage; accommodation and food service activities; and Agriculture, forestry and fishing.

Hendeku gjinor në paga është më i theksuar mes punonjësve që janë të punësuar në ndërmarrjet ekonomike që i përkasin grup-aktivitetit ekonomik “Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit”. Për këtë grup-aktivitet, hendeku gjinor në paga është 34,6 %. Krahasuar me vitin e mëparshëm hendeku gjinor në paga për këtë grup aktivitetesh ka rënë me 1,5 pikë përqindje.

Në vitin 2019, grup-profesionet më të paguara janë: Ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore dhe drejtorët ekzekutivë; Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); dhe Teknikët dhe specialistët në zbatim. Ndërsa grup-profesionet me pagë nën nivelin mesatar janë: Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit; punëtorët e profesioneve elementare; dhe zejtarët, artizanët dhe profesione të lidhura me to.

The gender pay gap is higher among employees who are employed in economic enterprises belonging to the economic activity group “ Mining and quarrying; manufacturing; electricity, gas, steam and air conditioning supply; water supply; sewerage, waste management and remediation activities”. For this group-activity, the gender pay gap is 34.6 %. Compared with the previous year, the gender pay gap for this group of activities has decreased by 1.5 percentage points.

In 2019, the most paid professions are: Lawmakers, senior civil servants and executive directors; Specialists with higher education (professionals); and technicians and specialists in implementation. Professions below the average level are: Qualified employees of forestry and fishing agriculture; workers of professional professions; and craftsmen, artisans and related professions.

Tab.1.1

Forca e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Labour force by education, age and sex

(numër - number)

Niveli arsimor Educational level	Grup-mosha Age-group	Gjithsej - Total		Meshkuj - Men		Femra- Women	
		2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej Total	Total (15 +)	1.404.059	1.430.375	790.661	794.916	613.398	635.459
	15-64	1.347.462	1.367.452	754.900	756.338	592.564	611.114
	20-64	1.316.415	1.335.321	733.804	736.597	582.612	598.724
	15-24	165.211	162.993	103.680	95.829	61.532	67.164
	25-29	183.328	194.619	104.072	107.572	79.254	87.047
	25-54	942.117	952.731	504.735	506.155	437.381	446.576
	55-64	240.134	251.727	146.486	154.353	93.650	97.374
	65+	56.597	62.923	35.762	38.578	20.835	24.345
Arsim 8/9 vjeçar Primary education	Total (15 +)	606.054	609.047	321.605	321.164	284.449	287.883
	15-64	561.600	562.193	296.310	295.630	265.290	266.563
	20-64	542.838	543.367	283.561	283.618	259.277	259.749
	15-24	49.881	45.408	32.443	28.276	17.439	17.132
	25-29	51.446	48.450	32.539	29.523	18.906	18.927
	25-54	398.907	401.498	204.534	204.180	194.373	197.318
	55-64	112.812	115.287	59.334	63.174	53.478	52.113
	65+	44.454	46.854	25.295	25.534	19.159	21.320
Arsim të mesëm Secondary education	Total (15 +)	517.385	517.131	344.814	341.786	172.571	175.345
	15-64	508.455	504.700	337.126	331.504	171.329	173.196
	20-64	496.192	491.445	328.779	323.825	167.413	167.620
	15-24	81.811	84.197	59.067	56.583	22.744	27.614
	25-29	55.864	60.777	41.718	45.531	14.144	15.246
	25-54	326.682	311.153	208.676	200.229	118.006	110.924
	55-64	99.961	109.350	69.383	74.692	30.579	34.658
	65+	8.930	12.431	7.688	10.282	...	...
Arsim të lartë Tertiary education	Total (15 +)	280.621	304.197	124.242	131.966	156.378	172.231
	15-64	277.408	300.559	121.464	129.204	155.945	171.355
	20-64	277.385	300.509	121.464	129.154	155.922	171.355
	15-24	33.519	33.388	12.170	10.970	21.349	22.418
	25-29	76.018	85.392	29.815	32.518	46.203	52.874
	25-54	216.528	240.080	91.526	101.746	125.002	138.334
	55-64	27.361	27.090	17.769	16.487	9.593	10.603
	65+	3.213	3.638	2.780	2.762	...	...

... informacion i disponueshëm por jo i përdorshëm / information is available but unusable

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2018-2019

Source of information: Labour Force Survey, 2018-2019

Tab.1.2

Punësimi sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Employment by education, age and sex

(numër - number)

Niveli arsimor Educational level	Grup-mosha Age-group	Gjithsej - Total		Meshkuj - Men		Femra- Women	
		2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej Total	Total (15 +)	1.230.852	1.265.583	690.637	702.612	540.215	562.971
	15-64	1.174.840	1.203.292	655.342	664.382	519.499	538.910
	20-64	1.153.422	1.180.451	641.985	651.447	511.437	529.004
	15-24	118.483	118.698	72.952	69.179	45.531	49.519
	25-29	149.515	162.169	86.722	90.886	62.793	71.283
	25-54	836.805	851.436	449.039	452.076	387.765	399.360
	55-64	219.553	233.156	133.351	143.127	86.202	90.029
	65+	56.012	62.291	35.295	38.230	20.717	24.061
Arsim 8/9 vjeçar Primary education	Total (15 +)	546.167	555.900	286.612	289.888	259.555	266.012
	15-64	502.112	509.334	261.645	264.497	240.467	244.837
	20-64	489.198	495.184	253.732	256.229	235.466	238.955
	15-24	37.461	37.055	23.308	21.449	14.153	15.606
	25-29	43.704	42.978	27.619	26.246	16.085	16.732
	25-54	360.094	364.602	183.773	184.465	176.321	180.137
	55-64	104.557	107.677	54.564	58.583	49.993	49.094
	65+	44.055	46.566	24.967	25.391	19.088	21.175
Arsim të mesëm Secondary education	Total (15 +)	443.426	442.855	294.525	294.656	148.901	148.199
	15-64	434.644	430.768	286.938	284.579	147.706	146.189
	20-64	426.139	422.099	281.494	279.934	144.645	142.165
	15-24	58.830	59.834	41.564	40.657	17.266	19.177
	25-29	46.063	49.099	35.173	37.509	10.889	11.590
	25-54	286.646	271.803	183.415	175.203	103.231	96.600
	55-64	89.168	99.130	61.959	68.719	27.209	30.411
	65+	8.782	12.087	7.587	10.077	...	...
Arsim të lartë Tertiary education	Total (15 +)	241.260	266.828	109.500	118.068	131.759	148.760
	15-64	238.085	263.190	106.759	115.306	131.326	147.884
	20-64	238.085	263.168	106.759	115.284	131.326	147.884
	15-24	22.192	21.809	8.080	7.073	14.112	14.736
	25-29	59.748	70.092	23.930	27.131	35.818	42.961
	25-54	190.065	215.031	81.852	92.408	108.213	122.623
	55-64	25.828	26.349	16.828	15.825	9.000	10.524
	65+	3.175	3.638	...	...	...	...

... informacion i disponueshëm por jo i përdorshëm / information is available but unusable

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2018-2019

Source of information: Labour Force Survey, 2018-2019

Tab.1.3

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë

Labour force participation rate by education, age and sex

%

Niveli arsimor Educational level	Grup-mosha Age-group	Gjithsej - Total		Meshkuj - Men		Femra- Women	
		2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej Total	Total (15 +)	59,4	60,4	67,6	68,0	51,4	53,0
	15-64	68,3	69,6	76,9	77,6	59,7	61,6
	20-64	74,8	75,9	84,5	84,4	65,4	67,6
	15-24	35,8	36,7	43,4	43,2	27,6	30,2
	25-29	78,3	82,0	88,1	88,3	68,3	75,3
	25-54	83,0	83,9	90,7	90,6	75,6	77,4
	55-64	63,7	65,2	78,5	79,4	49,1	50,8
	65+	14,5	15,6	19,0	19,8	10,4	11,7
Arsim 8/9 vjeçar Primary education	Total (15 +)	52,5	53,3	60,6	61,6	45,6	46,3
	15-64	63,6	64,4	71,0	71,9	57,0	57,6
	20-64	74,3	75,1	84,8	84,7	65,4	66,8
	15-24	24,8	23,4	29,9	28,3	18,8	18,2
	25-29	71,7	72,3	87,1	85,8	55,0	58,0
	25-54	79,9	80,3	88,7	88,6	72,3	73,2
	55-64	61,9	64,3	75,9	78,4	51,4	52,8
	65+	16,4	17,4	22,4	23,1	12,1	13,4
Arsim të mesëm Secondary education	Total (15 +)	63,0	62,7	73,3	72,4	49,1	49,7
	15-64	68,6	69,3	80,3	80,2	53,3	55,1
	20-64	72,7	73,0	84,2	83,4	57,4	58,8
	15-24	43,9	46,3	55,5	57,2	28,4	33,2
	25-29	76,8	82,8	89,3	89,2	54,3	68,1
	25-54	82,5	82,8	92,1	90,9	69,6	71,4
	55-64	63,0	64,3	79,7	79,5	42,6	45,6
	65+	11,1	12,8	15,2	17,5	4,1	5,7
Arsim të lartë Tertiary education	Total (15 +)	72,4	75,8	73,2	75,1	71,9	76,2
	15-64	79,2	82,4	84,0	86,0	75,9	79,9
	20-64	80,0	83,1	84,7	86,6	76,7	80,6
	15-24	45,2	48,9	51,2	48,2	42,3	49,3
	25-29	84,9	88,1	87,7	89,4	83,2	87,4
	25-54	90,3	92,4	92,1	94,4	89,1	91,0
